



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji,
Kulturë, Rini e Sport
Mbledhja nr. 35
Prishtinë, më 18.11.2009 ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës
Salla nr. N- 225

P R O C E S V E R B A L

nga mbledhja e Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport

Në mbledhje morën pjesë: Agim Veliu, Drita Kadriu, Arsim Rexhepi, Enis Kervan, Mark Krasniqi, Donika Kadaj-Bujupi, Hestet Cakolli dhe Dragan Dimiq.

Mungoi Memli Krasniqi.

Nga sekretaria e Kuvendit morën pjesë: Lule Ymeri dhe Drita Çarkaxhiu.

Në mbledhje prezantuan përfaqësuesi i OSBE-së, NDI-së, përfaqësuesi nga Presidencia përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit.

Mbledhjen e udhëhoqi Agim Veliu, kryetar i Komisionit.
Për këtë mbledhje është paraparë ky:

Rend dite

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.**
- 2. Shqyrtimi i Projektligjit për Mërgatën e Kosovës.**
- 3. Të ndryshme.**

Rendi i ditës u miratua nga anëtarët e Komisionit.

Agim Veliu -kryetar, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes.

Kryesuesi – theksoi se kërkesa e Kryesisë së Kuvendit të Kosovës lidhur me funksionimin e Këshillit për Trashëgimin Kulturor të Kosovës të datës 10.11.2009 është çështje urgjente dhe për këtë arsye në takim janë ftuar përfaqësuesit e Këshillit për Trashëgiminë Kulturorë dhe përfaqësuesit e Ministrisë së Kulturës. Përfaqësuesit nga MKRS nuk kanë marrë pjesë në mbledhje.

Për këtë arsye **kryesuesi**, prioritet i dha kësaj pike të rendit të ditës më pas për tu vazhduar me pikat e radhës.

1. Agim Veliu – kryetar tha se më parë do t'i dëgjojmë shqetësimet dhe kërkesat e anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimin e Kosovës dhe më pas Komisioni do të nxjerr Rekomandim në bazë të Ligjit për Trashëgimin Kulturorë.

Kryesuesi hapi diskutim lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

Edi Shukriu – ajo tha se në pajtim me Ligjin për Trashëgimin Kulturorë, në nenin 4.8 janë caktuar detyrat e funksionalizimit të KKTK, dhe si organ profesional funksionon nën autoritetin e legjislativ të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Në kuadër të përgjegjësive të KKTK, i cili organ është në përbërje prej 7 anëtarëve, ka miratuar Rregulloren e punës dhe se e njëjta është përpiluar në bashkëpunim me përfaqësuesen e MKRS - Burbuqe Deva, në zyrat e saja. Rregullorja është aprovua nga anëtarët e KKTK.

Në vazhdim theksoi se për zhvillimin e veprimtarisë së KKTK është shpall konkursi publik për zgjedhjen e stafit të Sekretarisë. Ndërkohë Ministri - Valton Beqiri nuk e ka përkrahë këtë konkurs, me arsyetim se procesi i tillë institucional do të krijojë paralelizma me Divizionin e Trashëgimisë Kulturorë dhe për veprimtarinë e tij ekziston stafi administrativ në kuadër të MKRS dhe se i njëjti kryen detyrat e funksionimit të trashëgimisë Kulturorë në Kosovë. Gjithashtu ka dhënë paragjykime se pagat janë më të larta se në MKRS.

Ajo konstatoi se fushëveprimataria e Sekretarisë së KKTK ka detyra të ndara nga MKRS dhe se nevojitet të ketë sekretari profesionale.

Mendon se Vendimi i Kryesisë së Kuvendit të Kosovës i datës 10.11.2009 ka ndikuar në pezullimin e aktiviteteve të KKTK-së dhe propozoi që sa më parë të bëhet deblokimi i aktiviteteve përmbyllëse për funksionalizimin e KKTK sipas autorizimeve të përshkruara me Ligj.

Nimon Alimusaj – ai diskutoi lidhur me çështjet e autoritetit, përgjegjësive të KKTK, si organ i themeluar në pajtim me Ligjin për Trashëgimin Kulturorë, në bazë të nenit 4.8 dhe i cili është aprovuar me vendim të Kuvendit të Kosovës. Në vazhdim theksoi se funksionalizimi dhe organizimi i brendshëm i KKTK rregullohet me akt të brendshëm të miratuar prej tij dhe pohoi se në bazë të këtij neni Këshilli i përgjigjet dhe i raporton Kuvendit të Kosovës .

Shkresa e drejtuar Kryesisë nga Ministri i MKRS Valton Beqiri lidhur me arsyetimin e tij se Sekretaria e KKTK paraqet njësi paralele me Divizionin e Trashëgimisë Kulturorë, ai mendon se është bërë me paragjykime të paqëndrueshme sepse veprimtaria e Këshillit duhet të funksionoj në mënyrë të pavarur, të përcaktuar me Ligj dhe sipas Rregullores së brendshme.

Në fund, vlerësoi se vonesa për funksionalizimin e KKTK për periudhën deri më 25 nëntor 2009 nuk do të lejojë shfrytëzimin e pjesës më të madhe të mjeteve të miratuara nga Kuvendi i Kosovës. Ai mendon se kontributi i Komisionit është shumë i rëndësishëm për rikthimin e funksionalizimit të KKTK .

Kryesuesi- për këtë pikë të rendit të ditës fjalën ua dha anëtarëve të Komisionit.

Enis Kervan – theksoi se në mandatin e dytë në Komisionin Parlamentar është themeluar KKTK në baze të Ligjit për Trashëgimin Kulturore dhe i njëjti është miratuar në vitin 2007 në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Më pas theksoi se si anëtar i këshillit ka bashkëpunuar me anëtarët e KKTK dhe stafin e MKRS dhe është nxjerr Rregullorja e punës në bazë të këtij Ligji. Për mos funksionalizimin e KKTK ai propozoi që Komisioni ose MKRS të marr iniciativë dhe ta ndryshojnë nenin 4.8 të Ligjit mbi Trashëgimi Kulturore ose KKTK të vazhdojë punën e vet në bazë të autorizimeve ligjore.

Arsim Rexhepi - kërkoi sqarime lidhur me çështjen e përzgjedhjes së kompetencave dhe për çështjen financiare të KKTK. Për çështjen e dytë kërkoi informatë shtesë lidhur me atë se sa janë paraparë të jenë pagat e anëtarëve të këshillit dhe të stafit punues.

Heset Cakolli – tha se KKTK në bazë të kompetencave të saja ligjore ka nxjerr Rregulloren e punës, ndërsa nga përfaqësuesit e KKTK kërkoi sqarim se cilat janë arsyet konkrete të cilat pengojnë MKRS që Këshilli të ketë Staf të vet profesional.

Donika Kadaj- Bujupi përkrah mendimet e parafolësve lidhur me çështjen e kompetencave të cilat duhet ti ketë KKTK. Ajo tha se caktimi i pagave dhe mënyra e shpenzimeve të mjete buxhetore të KKTK komfor Ligjit është çështje me të cilën duhet të merret auditori. Mendon se Komisioni duhet të dal me një vendim që të ç’bllokohen mjetet financiare të KKTK dhe ajo të vazhdoj punën e saj. Ajo propozoi që KKTK të dorëzoi një Raport preliminar lidhur me çështjen financiar dhe më pas komisioni të dalë me vlerësime konkrete.

Mark Krasniqi - mendon se duhet të bazohemi vetëm në Ligjet e miratuara në Kuvendin e Kosovës. Më pas theksoi se KKTK në bazë të Ligjit për Trashëgimin Kulturore është miratuar nga Kuvendi i Kosovës dhe Këshill duhet ti përgjigjet vetëm atij.

Edi Shukriu– tha se anëtarët e KKTK punojnë në mënyrë vullnetare pa pasur përkrahje nga MKRS. **Ajo vlerësoi** se Kuvendi i Kosovës ka miratuar buxhetin e KKTK ndërsa shuma për kompensim të anëtarëve të KKTK ende nuk është **caktuar** dhe shtoi se nga ky buxhet janë shpenzuar vetëm 200 euro për mbushje të kartelave telefonike. Më pastaj theksoi se pagat për sekretari janë caktuar nga Ministria e Administratës Publike në bazë të koeficientit të shërbyeseve civil. Ne vijim diskutoi se Rregullorja është miratuar në mars 2009 dhe KKTK nga kjo periudhë punon në bazë të kompetencave të saja andaj propozoi se duhet të ketë Sekretari profesionale për funksionalizimin e detyrave që dalin nga KKTK.

Agim Veliu – kryetari, tha se në bazë të Ligjit për Trashëgimin Kulturore neni 4.8, Këshilli është organ që përcakton objektivat e veprimtarisë në fushën e Trashëgimisë Kulturoren, i cili është në përbërje nga 7 anëtar dhe zgjidhet me mandat 3 vjeçar nga Kuvendi i Kosovës dhe njëkohësisht respekton përbërjen etnike në Kosovë. Kuvendi i Kosovës ka miratuar buxhetin e KKTK dhe në fund shtoi se mënyra e organizimit dhe funksionimit të KKTK rregullohet me një akt të brendshëm të miratuar prej tij. Më pastaj **Kryesuesi** vlerësoi se më parë duhet të bëhet interpretimi i Ligjit për Trashëgimin Kulturore sepse Ligji nuk përcakton që KKTK të ketë staf profesional.

Kryesuesi – theksoi, me që në këtë mbledhje ka munguar njëra palët atëherë Komisioni vendosi që në mbledhjen e cila do të mbahet më 23.11.2009 në orën 11:00, të ftohet përfaqësuesi i Ministrisë së Kulturës dhe përfaqësuesi i Administrues Publike që të ofrojnë opinionet e tyre lidhur me funksionimin e Këshillit për Trashëgimin Kulturore të Kosovës. Në bazë të diskutimeve që do të dalin nga ky takim, Komisioni do të nxjerr Rekomandim të bazuar në Ligj.

Pasi nuk kishte propozime tjera, kryetari propozoi që të vazhdohet me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Kryesuesi, konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes të datës 28.10.2009

2. Shqyrtimi i Projektligjit për Mërgatën e Kosovës.

Agim Veliu – tha se në bazë të proceduarave të rregullta duhet të caktohet raportuesi për Projektligjin për Mërgatën e Kosovës i cili do të merret me proceduarat e mëtejshme deri në amendamentimin e Ligjit nga ana e Komisionit.

Komisioni propozoi që Drita Kadriu të jete referuese e Projektligjit për Mërgatën e Kosovës.

Mbledhja përfundoi në orën 12,010.

Kryetari i Komisionit

Agim Veliu